

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Gezim Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurit H.S. nga fshati ... tani me vendbanim ne ... ne rrugën "...", për shkak të veprave penale, **Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-ës**, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II-Nr.1322/2015 të datës 06.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2019, në mungesë te prokurorit te shtetit, e ne prezencë te të pandehurit H.I. , pas shpalljes së aktgjykimit, me datë 22.05.2019, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I PANDEHURI: H.I.**, nga i ati ... e ëma ... e vajzërisë ..., i lindur me datë me ..., në fshatin ..., tani me vendbanim ne ..., me nr. personal ..., i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, me parë i pa dënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Me dt. 21.09.2015, rreth orës 14:40 min. ne rrugën rajonale ... saktësisht në fshatin ..., Komuna e ... afër qumështores "...” nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik si dhejetën e njerëzve, ashtu qe duke drejuar automjetin e tije te markës “VW Golf” ngjyre hiri, me targa te regjistrimit ..., e ne kundërshtim me dispozitat 54 te LSKR, sepse shpejtisin e lëvizjes nuk ja ka përshtat kushteve dhe gjendjes ne rruge ashtu qe humb kontrollin ndaj automjetit, del nga rruga ne anën e majte duke u rrokullisur, ku vet i pandehuri pëson lëndime, ndërsa bashkudhëtarja (nena e tije) A.S. pëson lëndime te renda trupore ,e qe nga lëndimet e marra, sipas raportit mjekësor mbi vdekjen, e ndjera ndrron jetë ne spital ne Prishtine me datën 30.09.2015 ne ora 13:05min.

**Me këtë ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-ës**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 17, 23, 41, 73, dhe nenit 78, si dhe nenit 248 të KPPK-së dhe nenit 365, 450,463, të KPPK-së,

Ne baze te nenit 77 dhe 78 te kodit penal te Kosovës i pandehuri:

**LIROHET NGA DËNIMI**

Për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-ës

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 10 euro, ndërsa në emër të ekspertizës së komunikacionit shumen prej 40.88 euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike palët e dëmtuara udhëzohen në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP-II-Nr.1322/2015 të datës 06.07.2016 kundër të pandehurit H.I. nga fshati ... tani me vendbanim në ... në rrugën "...", për shkak të veprave penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 e lidhur me par.6 e 1 të KPRK-ës. Pas pranimit të aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 08.05.2019, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri H.I. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe njëherit ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe se njëherit ka deklaruar se ndjehet keq për rastin që ka ndodhur dhe se në këtë rast unë ndihem i dëmtuar dhe i pikëlluar ngase nëna ime ka humbur jetë në këtë aksident dhe njëherit në fjalën përfundimtare i pandehuri i propozon gjykatës që ta liroj nga dënimi ngase në këtë aksident kam humbur me të çmuarën time nënën.

Prokurori i shtetit me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se pasi që i pandehuri e pranon fajësinë për veprën që i vihet në barrë edhe unë jam në pajtim me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të marrë parasysh si rrethanë lehtësuese

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi që i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bën në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje të qarte ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, të gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë në përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës si: raporti i oficerit i dt. 21.09.2015 ekspertiza e fatkeqësisë së komunikacionit e dt.21.09.2015 lëshuar nga eksperti ing. B.S., raporti mjekësor për vdekjen e QKUK - klinika e ortopedisë në Prishtinë e dt. 30.09.2015, nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 e lidhur me par.6 e 1 të KPRK-ës

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që të pandehurin H.I. ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartshënuar. Duke u bazuar në nenin 78 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së, është përcaktuara se “Gjykata mund të lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryer nga pakujdesia nëse pasojat e asaj vepre penale e godasin kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij”.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues duke marrë për bazë të gjitha këto rrethana ka ardhur në përfundim se, do të ishte i panevojshëm dënimi për realizimin qëllimit të tij, sa i përket veprës penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase vetë privimi nga jeta e nënës së tij, është një pasojë që e ka goditur tejet rëndë të pandehurin.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që te pandehurin ta detyroj që shpenzimet procedurale - paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej 10€ (dhjetë euro), ndërsa ne emër te ekspertizës se komunikacionit shumën prej 40.88 euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro). Te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata konstatoi se nuk kishte kërkesë pasurore juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P. nr.534/2016 dt.22.05.2019**

Procesmbajtësja :

**Hasnije Muhaxheri**

Gjyqtari :

**Gëzim Ademi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne Gjykata e Apelit ne Prishtinë, përmes kësaj gjykate.